



Nr. 07 Prot.

Tiranë, më 15 / 06 / 2024

V E N D I M

Nr. 6, datë 15 / 06 / 2024

PËR

NGRITJEN E QENDRAVE TË VOTIMIT NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

Mbështetur në rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 - 2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Neni 8 dhe Neni 9; Vendimit Nr. 7, datë 28/05/2024 të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e numrit të qendrave të votimit në Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete/Institut”, pasi vlerësoi ambientet që ky fakultet disponon, Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës:

VENDOSI:

1. Ngritjen e 2 (dy) qendrave të votimit për zgjedhjet e autoriteteve dhe organeve drejtuese 2024-2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Qendrat e Votimit do të jenë në godinën e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI), ku FAU zhvillon aktivitetin mësimor dhe kërkimor.
3. Sallat në katin përdhe të FTI-së me emërtimet **FIE_LAB 1**, **FIE_LAB 2** dhe **FIE_LKP** do të jenë plotësisht në dispozicion të KQV-ve e KZF-së nga data **20.06.2024** deri më datë **21.06.2024**.
4. Sallat me emërtimet **FIE_LAB 1** dhe **FIE_LAB 2** do të shërbejnë si Qendra Votimi si dhe për ushtrimin e detyrave e kompetencave të KQV-ve.



5. Salla me emërtimin **FIE_LKP** do të shërbejë si ambient ndihmës në disa prej proceseve të parashikuara për t'u realizuar nga KQV-të dhe KZF-ja.

**KOMISIONI I ZGJEDHJEVE
NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**

Irina BRANKO	-	Kryetar	
Jonida MENIKU	-	Anëtar	
Blerina TABAKU	-	Anëtar	
Saimira ARAPI	-	Anëtar	
Enxhi KËRI	-	Anëtar	
Ardiana DERVISHI	-	Sekretar	